



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 02.05.2023

Nr: 422

VENDIM

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 309, DATË 12.4.2023 "PËR SHPËRNDARJEN E FONDEVE VJETORE PARTIVE POLITIKE NË FORMËN E NDIHMËS FINANCIARE VJETORE PËR VITIN 2023"

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat "k" dhe "n", e 2, 65, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neneve 15/2, pika 2, shkronja "e", 19, pika 2, 23/3, pika 2, dhe 24 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar, të ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", vendimit nr. 21, datë 13.07.2021, të Komisionit Rregullator "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.04.2021" dhe vendimeve nr. 406, 407, 408, 409, 410, 411, 412, 413, 414, 415, 416 dhe 417, datë 23.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N:

Referuar shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 7267/1 prot., datë 25.04.2023, në të cilën nuk miratohet kërkesa sipas propozimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me detajimin e fondeve për Partinë Demokratike, faturës së kryer në datë 28 prill 2023 nga Partia Demokratike ndaj auditueses ligjore zj. Meri Lika, si dhe shkresës të zj. Lika nr. 4469 prot., datë 2.5.2023, në të cilën vërteton pagesën që i është bërë nga Partia Demokratike,

Data: 02.05.2023 Nr: 422



"Për një ndryshim në vendimin nr.309, datë 12.04.2023_ Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2023"

V E N D O S:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 309, datë 12.4.2023, sipas lidhjes nr 1 (një) që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Lidhja nr. 1

Nr.	Partitë Politike	70% - 2/a / lekë	20% - 2/b / lekë	10% - 2/c / lekë	Pjesa e mbetur e 10% - 2c1 / lekë	Totali për çdo parti / lekë
1	PS	127.872.000	6.283.636	16.820.352	518.794,97	151.494.783
2	PD	86.400.000	6.283.636	13.627.008	350.537,14	106.661.182
3	PDIU	3.456.000	6.283.636		14.021,49	9.753.658
4	PBDNJ	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
5	PR	5.184.000	6.283.636		21.032,23	11.488.669
6	PAA	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
7	LZHK	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
8	PLL	1.728.000	6.283.636		7.010,74	8.018.647
9	PL	6.912.000	6.283.636	2.353.536	28.042,97	15.577.215
10	PSD	5.184.000	6.283.636	777.600	21.032,23	12.266.269
11	NTH		6.283.636			6.283.636
	Totali	241.920.000	69.120.000	33.578.496	981.504	345.600.000